



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022, miratoi këtë;

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **04 mars 2022 deri më 04 prill 2022**, brenda së cilës Drejtoritë përkatëse mund të organizojnë diskutime të ndryshme publike, kurse Debatit publik me qytetarë mbahet më **22 mars 2022** duke filluar nga **ora 16:00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatës diskutimeve dhe debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; **liridona.rrahmani@rks-gov.net**; të cilat pastaj përcjellën në Drejtoritë përkatëse bartëse të subvencioneve, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **<http://kk.rks-gov.net/podujeve>** (*rubrika; aktet për diskutim publik*)


Neni 5

Diskutimet /debatet publike zbatohen nga Drejtoritë përkatëse në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdesen për përgatitjen e raportit nga diskutimet /debatit publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot.01-070/05-0014619/22
Podujevë,
28 shkurt 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DRAFT

RREGULLORE
PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E
NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Podujevë, Shkurt 2022

Bazuar në nenin 58 shkronja h) ndërlidhur me nenet 5 shkronja f), 12.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 17 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 36 paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013-MF-Shpenzimi i parave publike, si dhe nenin 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 3 paragrafi 1.6, nenin 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i

Propozohet

RREGULLORE PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat që i mundësojnë Komunës së Podujevës ndarjen e mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat përkatëse të cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik, si dhe vendosjen e një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin dhe subvencionimin të projekteve, aktiviteteve si dhe dhënies së ndihmës për nevoja të ndryshme të qytetarëve.
2. Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve në fushat e Arsimit, Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Kulturës Rinisë dhe Sportit, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit familjeve me vendbanim në territorin e Komunës së Podujevës, për strehim, për mbulimin e qirasë së banimit.
3. Komuna subvencionon projekte të Shoqatave dhe OJQ-ve të ndryshme si persona juridik me karakter jo profitabil të regjistruara në Ministrinë përkatëse. Për përfitimin e subvencioneve i nënshtrohen parimeve dhe dispozitave të përgjithshme dhe të veçanta të Rregullores së Ministrisë së Financave për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, që është në fuqi.
4. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit.

Neni 2 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

Komuna dhe organet e saj, ka kuptimin e përcaktuar sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale.
Subvencionet, në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohet ndihma apo mbështetja e pakthyeshme e mjeteve buxhetore të Komunës, në llogarinë rrjedhëse të përfituesit, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik si dhe ndihmës momentale për personat në nevojë.

Pagesa e pakthyeshme, është e njëanshme, atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

Mbështetje financiare, nënkupton çdo formë të mbështetjes për persona fizik dhe juridik, e cila shprehet në vlerë monetar pavarësisht emërimit të saj.

Përfituesi, nënkupton personat fizik dhe juridik që mund të jenë përfitues të mjeteve financiare dhe subvencioneve tjera nga kategoria e subvencioneve dhe transferove të planifikuar në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.

Banor rezident, nënkupton personin që jeton dhe vepron në Komunën e Podujevës dhe që posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Marrëveshja/Kontratë, nënkupton dokumentin e nënshkruar mes Komunës dhe përfituesit për zbatimin e projektit përfitues.

Komisioni, në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton komisionin përkatës të themeluar nga Kryetari i Komunës.

Neni 3 Limitet buxhetore

1. Komuna ndanë subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. Kryetari i Komunës, lejon ndarjen e subvencioneve për persona juridik deri në shumën 10,000.00€, shumë e cila ka kuptimin e vetëm një përfituesi.
3. Kryetari i Komunës, lejon ndarjen e subvencioneve për persona fizik deri në shumën 5,000.00€, shumë e cila ka kuptimin e vetëm një përfituesi.
4. Kryetari i Komunës, lejon ndarjen e subvencioneve në shumë edhe mbi 10,000.00€ për kategorinë e përfituesve të cilat i nënshtrohen procedurave sipas Rregullores së Ministrisë së Financave për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, që është në fuqi
5. Nëse ndihmat financiare kanë të bëjnë me shumë më të madhe, se që është përcaktuar në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, vendosë Kuvendi i Komunës.

Neni 4

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna, nëse nuk ka obligime ndaj Komunës, përveq rasteve sociale, fatkeqesive natyrore dhe rasteve të renda shëndetësore.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik, mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes/ftesës publike apo në raste të veçanta në bazë të kërkesave individuale të arsyetuara, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike, zhvillohet sipas procedurave të parapara në këtë Rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarjen e subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës, bëhet brenda 20 ditëve pune nga parashtrimi i kërkesës.
- 5.

Neni 6

Përfashtimet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës.
2. Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përfashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenie sociale.
4. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo në marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 3 (tre) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës ngritë komisione të përkohshme ad-hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
2. Komisionet ngriten për secilën thirrje publike, dhe përbëhet prej 3 deri në 5 anëtarë nga fushat specifike të Drejtorisë përkatëse, si dhe të reflektoj barazinë gjinore.

3. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil të Komunës apo në raste të veçanta specifike mund të jetë edhe ndonjë anëtar i jashtëm në cilësinë e ekspertit të fushës.
4. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë, dhe procedurat sipas kësaj rregulloreje si dhe akteve tjera përkatëse ligjore që rregullojnë fushën e subvencioneve.
5. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kushteve dhe kritereve për ndarje të subvencioneve sipas kësaj rregulloreje dhe akteve tjera përkatës në fuqi.
6. Kryetari i Komunës ngritë komision të veçantë për rastet dhe kërkesat individuale për subvencione sipas kësaj rregulloreje, të cilat paraqiten jashtë thirrjeve publike.
 - 6.1. Komisioni mund ngritët në përbërje prej 5 anëtarëve nga zyrtarë të Drejtorive përkatëse që kanë planifikuar ndarjen e subvencioneve, apo komisione të veçanta në përbërje prej 3 anëtarëve për secilën Drejtori e cila ka të planifikuara ndarjen e subvencioneve.
7. Caktimi i anëtarëve të komisioneve bëhet në koordinim me drejtorët e Drejtorive përkatëse që kanë planifikuar ndarjen e subvencioneve.

Neni 8

Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave

1. Komisioni shqyrton dhe vlerëson kërkesat/aplikacionet për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 20 ditë pune, pas përfundimit të afatit sipas shpalljes/ftesës publike.
2. Komisioni sipas paragrafit 6 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, brenda afatit ligjor shqyrton kërkesat dhe me rekomandim i drejtohet Kryetarit të Komunës.
 - 2.1. Në rast se Komisioni vlerëson se kërkesa nuk i plotëson kushtet, kriteret apo çështje tjera ligjore-procedurale për mbështetje dhe subvencionim sipas kësaj rregulloreje, kërkesa refuzohet me vendim nga ana e Komisionit.
3. Komisioni vepron në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe legjislacionin në fuqi që i referohet ndarjes së mjeteve financiare nga kategoria subvencione dhe transfere.
4. Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
5. Komisioni mban procesverbal nga takimet dhe aktivitetet tjera gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave/aplikacioneve.
6. Pas përfundimit të shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave/aplikacioneve sipas shpalljes/ftesës publike, komisioni publikon në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve rezultatet e përfituesve të përzgjedhur, përfshirë edhe çështjet tjera relevante që ndërlidhen me subvencionimin përkatës, me theks, të drejtën dhe afatin e parashtrimit të ankesës.

7. Në rast të mos paraqitjes së ndonjë ankesë brenda afatit të paraparë me këtë rregullore, rezultatet e publikuara paraprakisht shndërrohet në rezultatet përfundimtare dhe i rekomandohet Kryetarit të Komunës për miratim.
8. Në rast të paraqitjes së ndonjë ankesë brenda afatit të paraparë me këtë rregullore, ankesat shqyrtohen nga Komisioni i ankesave sipas neneve 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës ngritë komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve sipas kësaj rregulloreje.
2. Komisioni përbëhet prej 3 deri në 5 anëtarë nga radhët e shërbyesve civil dhe atë nga fushat specifike të Drejtorive përkatëse, me mandat 2 vjeçar si dhe reflekton barazinë gjinore.
3. Anëtarë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët janë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

Neni 10

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

1. Ankesa mund të parashtrohet në afat prej 5 ditë pune, pas publikimit të rezultateve sipas nenit 8 paragrafit 6 të kësaj rregulloreje.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim brenda afatit prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.
3. Komisioni për ankesa gjatë vendimmarrjes vepron në bazë të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
4. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, dhe janë vendime përfundimtare në procedurë administrative.
5. Me vendimin e komisionit të ankesave njoftohet parashtruesi i ankesës dhe komisioni vlerësues.
6. Procedura e parashtrimit dhe zgjidhjes së ankesave sipas kësaj rregulloreje vlen edhe për rastet sipas kërkesave individuale për subvencione, të cilat paraqiten jashtë thirrjeve publike.

Neni 11

Vendimmarrja

1. Kryetari merr vendim për ndarjen apo lejimin e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit dhe shpalljes/ftesës përkatëse publike, në afat prej 5 ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare, konform procedurave të kësaj rregulloreje.
2. Kryetari i Komunës merr vendim për ndarjen subvencioneve apo lejimin e mjeteve financiare si formë e përkrahjes, ndihmës dhe të ngjashme në përputhje me

rekomandimin e komisionit përkatës sipas kërkesave individuale të paraqitura jashtë thirrjeve/ftesave publike.

3. Kryetari i Komunës mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rishqyrtimin dhe rivlerësimin e kërkesave/aplikacioneve apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision tjetër ad-hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

4. Kryetari i Komunës, varësisht mundësive buxhetore të planifikuara në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, mund të lejoj mjete financiare për raste emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si formë e ndihmës dhe përkrahjes për daljen nga situata.

4.1. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni i ngritur sipas nenit 7 paragrafi 6, dhe të njëjtat trajtohen sipas kësaj rregulloreje.

4.2. Kërkesat sipas paragrafit 4 të këtij neni, duhet t'i plotësojnë, por pa u kufizuar, në këto kritere:

-dëshmi për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme natyrore dhe fatkeqësitë tjera (nga Zjarrfikësit, Shërbimi Policor i Kosovës, komisioni përkatës komunal)

-dëshmia për veprimtarinë e caktuar bujqësore, biznesore dhe gjendjen e rëndë ekonomike-sociale të familjes, si dhe për lëmi dhe situata tjera të ngjashme.

Neni 11

Ekzekutueshmëria e vendimit

Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve sipas kësaj Rregullore bëhet i ekzekutueshëm atëherë kur janë përmbushur kushtet, kriteret dhe procedurat përkatëse të parapara me këtë Rregullore dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

Neni 12

Shpallja Publike për ndarjen e subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në web faqen e komunës dhe në tabelën e njoftimeve.
2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar ndarjen e Subvencioneve, të cilat përcaktohen sipas kësaj rregullore.
3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë pune nga data e shpalljes.

Neni 13

Marrëveshja/kontratë për subvencionim

1. Për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje/kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit.
2. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante.

Neni 14
SUBVENCIONET NË FUSHËN E ARSIMIT

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. bursa për student;
 - 1.2. bursa për nxënës në shkollë të mesme;
 - 1.3. bursa për nxënës në shkolla fillore;
 - 1.4. kuadrot defëitar;
 - 1.5. nxënësit me nevoja të veçanta;
 - 1.6. gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);
 - 1.7. botimin e librave/revistave;
 - 1.8. nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - 1.9. mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 15
Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta:
 - 1.1. Për student;

-nota mesatare, prej 9 deri 10.....	30 pikë
-nota mesatare, prej 8 deri 9.....	20 pikë
-nota mesatare, prej 7 deri 8.....	15 pikë
-nota mesatare, prej 6 deri 7.....	10 pikë
 - 1.2. Për nxënës;

-suksesi me gjitha notat 5.....	30 pikë
-suksesi - shkelqyeshem.....	20 pikë
-suksesi - shume mire.....	15 pikë
-suksesi - mire.....	10 pikë
-suksesi - mjaftueshme	5 pikë
 - 1.3. numri i studentëve apo nxënësve në familje...(2 e me shumë)..... 10 pikë | - 1.4. kategoritë e dala nga lufta,..... 10 pikë | - 1.5. Studenti / nxënës me asistence sociale..... 10 pikë | - 1.6. Student dhe nxënës ne fushat ku ka mungese te kuadrove 10 pikë | - 1.7. Student dhe nxënës me nevoja te veçantë..... 10 pikë | - 1.8. Studentet / nxënësit pa dy prinderit..... 20 pikë | - 1.9. Student / nxënës pa njërin prindër 10 pikë |

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1. dokumenti i identifikimit;
 - 2.2. certifikata e notave;
 - 2.3. certifikata e vitit kalendarik të studimeve;
 - 2.4. certifikatë e vendbanimit;
 - 2.5. dëshmia mbi gjendjen ekonomike;
 - 2.6. dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta;
3. Studenti apo nxënësi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga niveli qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë.
4. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në web faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.

Neni 16

SUBVENCIONET NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK

1. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për fushat:
 - 1.1. zejjet tradicionale dhe bashkohore;
 - 1.2. aksesorë;
 - 1.3. agrobizneset;
 - 1.4. teknologji Informative;
 - 1.5. ndërmarrjet publike;
 - 1.6. biznese inovative;
 - 1.7. ndërmarrje sociale;
 - 1.8. inkubatorët e biznesit;
 - 1.9. “Start-up” bizneset;
 - 1.10. aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit;
 - 1.11. aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.
 - 1.12. Bizneset tjera prodhuese
2. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik, mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në territorin e Komunës së Podujevës.
3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik, nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Neni 17

Kriteret e përgjithshme

1. Përfitues të subvencioneve (granteve) mund të jenë bizneset ekzistuese dhe ato fillestare (start-up), kriter i cili specifikohet me thirrjen/ftesën publike për aplikim.
2. Bizneset duhet të jenë ndërmarrje në pronësi 100% private (sipas definicionit të rregulluar me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës).
3. Bizneset duhet të jenë në gjendje të dokumentojnë qëndrueshmërinë ekonomike, si dhe të kenë të përmbushur të gjitha obligimet, kontributet dhe tatimet përkatëse.
4. Përfituesit duhet të marrin pjesë në bashkëfinancim në vlerën prej minimum 30% të projektit. Projekt i cili do të specifikohet në thirrjen/ftesën publike për aplikim.
5. Përfituesit duhet të gjerorjnë vende të reja pune.
6. Bizneset dhe idetë për biznese të cilat udhëhiqen nga grat dhe të rinjtë.
7. Përfitues të subvencioneve të Komunës së Podujevës mund të jenë të gjitha veprimtaritë biznesore sipas kësaj rregulloreje.

Neni 18

Kriteret specifike të detajuara me poëtim numerik të cilat do të publikohen në thirrjen/ftesën për aplikim përpilohen nga Drejtoria përkatëse.

Neni 19

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi rasteve specifike si në vijim:
 - 1.1. bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;
 - 1.2. grave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevoja të veçanta dhe komuniteteve;
 - 1.3. bizneset që kanë siguruar bashkëfinancim nga palë të treta prej më shumë se 50% të vlerës;
 - 1.4. bizneset të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale.
 - 1.5. OJQ-të të cilët aplikojnë me projekte biznesi të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës.
 - 1.6. bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga Komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal, nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për zhvillim ekonomik të ndarë nga niveli qendror ose nga ndonjë donator tjetër.
2. Bizneset e përcaktuara në paragrafin 1.3 dhe 1.4 të këtij neni, mund të aplikojnë për ndarje të subvencioneve edhe jashtë periudhës së shpalljes publike me kërkesë të arsyetuar.

Neni 20
Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për
subvencione për zhvillim ekonomik

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1. plani i biznesit;
 - 1.2. dokumenti identifikues;
 - 1.3. certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
 - 1.4. certifikata e biznesit;
 - 1.5. dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.6. dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.7. dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - 1.8. dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim);
 - 1.9. konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit;

Neni 20
SUBVENCIONET

NË FUSHËN E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

1. Komuna mund të ndajë subvencione në fushën e bujqësisë duke përfshirë, por pa u kufizuar, dhe atë:
 - projekte të fermerëve, shoqatave dhe kooperativave bujqësore nga lëmia e bujqësisë, me prioritet për fermerët dhe Komunën e Podujevës: lavërtari, pemëtari, vreshtari, perimtari, blegtori, peshkim, shpeztari, bletari.
 - për organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studimore e të tjera të ngjashme.
 - mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim.
 - projekte të ndryshme në sektorin e pylltarisë dhe zhvillimit rural.
 - ndarjen e pajisjeve dhe mekanizmit bujqësor.
 - ngritjen e serave.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:
 - 2.1. Ndarjes proporcionale sipas zonave/rajoneve. (Në rast kur nga zona/rajoni përkatës nuk e kemi minimumin e kërkesave për respektimin e ndarjes proporcionale atëherë përfitues i një subvencioni shtesë do të jetë rajoni i cili ka parashtruar më shumë kërkesa);
 - 2.2. Grave dhe të rinjve.
 - 2.3. Aplikantëve që kanë siguruar bashkëfinancim nga ndonjë donatorë i tretë vlerën e projektit minimum 30%, me përjashtim nëse në ftesën/thirrjen publike përcaktohet ndryshe.
 - 2.4. Aplikantëve, familja e të cilëve nuk kanë përfituar ndonjë projekt/subvencion nga Komuna, niveli qendror apo institucione tjera në drejtim të kësaj fushe në tri vitet e fundit.

- 2.5. personave me nevoja të veçanta dhe komuniteteve.
 - 2.6. Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga Komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.
3. Komuna mbështet projekte në tërësi apo edhe në formën e bashkëfinancimit nga ana e fermerëve ku fermeri merr pjesë minimum 30% të vlerës së projektit.

Neni 21

Kriteret specifike të detajuara me poentim numerik të cilat do të publikohen në thirrjen/ftesën për aplikim përpilohen nga Drejtoria përkatëse.

Neni 22

1. Subvencionimi në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, mund të bëhet përmes proceduarve të parapara të prokurimit publik, përkrahjes financiare, ndihmës në rastet e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, përmes pagesave direkte pas investimeve të bëra nga fermerët dhe konstatimit nga ana e komisionit komunal konform kriterëve të përcaktuara me thirrjen/ftesën publike, si dhe formave tjera të parapara me rregullativ ligjore.
2. Subvencionimi mund të bëhet edhe përmes marrëveshjeve të Komunës me donatorë të ndryshëm për projekte me interes të përgjithshëm duke zbatuar rregullat financiare të aplikueshme sa i përket ekzekutimit të pagesave.

Neni 23

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1. numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 1.2. certifikata e biznesit;
 - 1.3. projekti dhe plani financiar;
 - 1.4. fletëposedim për patundshmëri;
 - 1.5. dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.6. dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.7. dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - 1.8. konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë e aplikuesit;
 - 1.9. dokumenti identifikues i personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit.
 - 1.10. dëshmi se nuk është përfitues i një subvencionit të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 1. letërnjoftimi i fermerit kopje;
 2. fletëposedimi (origjinal) për patundshmëri;
 3. dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

Neni 21
SUBVENCIONET

NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

1. Komuna mund të ndanë subvencione për persona fizik për përballimin e shpenzimeve të shërimit sipas kritereve të përcaktuara nga Drejtoria përkatëse për shëndetësi.
2. Komuna varësisht mundësive buxhetore të planifikuara, ndanë subvencione për organizata (OJQ) për përballimin e shpenzimeve për të cilat ushtrojnë aktivitete publike.
3. Subvencionet për shëndetësi jepen për:
 - 3.1. rastet e rënda shëndetësore;
 - 3.2. rastet e sëmundjeve jo të rënda por pa burim të të ardhurave;
 - 3.3. trajtimi jashtë vendit;
 - 3.4. lehona;
 - 3.5. fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik;
 - 3.6. mirëqenie sociale.
4. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 4.1. numri i anëtarëve të familjes;
 - 4.2. çështja e banimit;
 - 4.3. kostoja e trajtimit;
 - 4.4. gjendja ekonomike familjare;
 - 4.5. trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).
5. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 5.1. diagnoza e mjekut specialist;
 - 5.2. dokumenti i identifikimit;
 - 5.3. konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
 - 5.4. dëshmia e shpenzimeve mjekësore.
 - 5.5. personat, për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpallje publike por me kërkesë të arsyetuar, duke respektuar rregullativën ligjore në fuqi.
6. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për organizata (OJQ) përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 6.1. Aplikacioni
 - 6.2. Certifikata për regjistrimin e OJQ-së,
 - 6.3. dokumenti identifikues i personit të autorizuar
 - 6.4. Projekt-propozimi duke përfshirë pjesën narrative dhe atë financiare

- 6.5. Dëshmi se subvencioni i pranuar nga viti paraprak është përmbyllur sipas destinimit për çka është ndarë me dëshmitë përkatëse
- 6.6. konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit

Neni 22

SUBVENCIONET NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. klubet sportive
 - 1.2. sportistët e dalluar
 - 1.3. garat sportive
 - 1.4. shoqëritë amatore (ansamblet)
 - 1.5. teatrot amatore
 - 1.6. festivalet
 - 1.7. botimi i librave
 - 1.8. ekspozitat
 - 1.9. aktivitete me karaktere garuese
 - 1.10. pjesëmarrje në festivale jashtë komune
 - 1.11. promovim i librave
 - 1.12. promovim i talenteve të rinj
 - 1.13. aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS
 - 1.14. KVRL dhe Qendra Rinore

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 2.1 projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
 - 2.2 projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurisë së qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
 - 2.3 Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 3.1 projekt propozimi;
 - 3.2 aplikacioni;
 - 3.3 dokumenti identifikues;
 - 3.4 certifikatë e vendbanimit (për persona fizik);
 - 3.5 certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
 - 3.6 dëshmi për pagesën e taksave komunale;

- 3.7 dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
- 3.8 dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
- 3.9 konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

Neni 23

Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj).
3. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen kontratë në mes palës përfituese dhe Komunës.
5. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohet dhe një kopje e tyre dorëzohet në Drejtorinë përkatëse që ka ndarë subvencionin.

Neni 24

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.
2. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes, të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 25

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas nxjerrjes së vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari i Komunës.
2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbaj: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që iu janë ndarë
3. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, varësisht natyrës së rastit komuna nuk publikon subvencionet për rastet përkatëse sipas nenit 21.
4. Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve si dhe mund të publikohen edhe në vende të frekuentuara brenda territorit të Komunës.

Neni 26

Parandalimi i konfliktit të interesit

1. Çdo person fizik dhe juridik i cili mund të jetë i përfshirë në subvencionet që ndan Komuna dhe që ekziston dyshimi se mund të jetë në konflikt të interesit, obligohet të paraqes rastin apo eventualisht të tërhiqet me shkrim nga procedura përkatëse.
2. Në fillim të çdo procedure të përzgjedhjes Komisionet duhet të sigurojnë që të mos ekzistoj konflikti i interesit i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
3. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve mund të jetë apo ekziston dyshimi se mund të jetë në konflikt të interesit në procedurën e përzgjedhjes së përfituesve, i njëjti është i detyruar ta paraqet me shkrim dhe njëkohësisht të kërkoj zëvendësimin e tij.
4. Në rastet e paraqitura sipas paragrafit 3 të këtij neni, Kryetari i Komunës me vendim cakton anëtarin/ët ad-hoc në kuadër të komisionit përkatës.

Neni 27

Dispozitat transitore dhe shfuqizuese

1. Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vazhdon me rregullativën ekzistuese, pavarësisht nëse kjo rregullore hyn në fuqi.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr.prot.01/111-400 e datës 28 maj 2012 dhe plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.prot.01-172-400 e datës 27 shtator 2012 dhe Rregulloren nr.prot.01-006-26348 të datës 30.03.2016

Neni 28

Hyrja ne fuqi

Pas miratimit final, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimi në gjuhët zyrtare në web faqen e Komunës.

Nr.prot. 01-070/05-0011515/22
Podujevë,
16 shkurt 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi

